

114



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRI

Nr. 391/3 Prot.Tiranë, më 02/08 2019

URDHËR

Nr. 404, Datë 02.08.

“PËR

**HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT,
NOTERES ERNELA ÇUBERI”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 3/b, nenit 7, shkronja “d)”, neneve 8, 12, 16, 42, 45, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar, pas marrjes së mendimit të Këshillit të Dhomës së Noterisë Durrës, administruar me shkresën me nr. prot. 391/1, datë 18.01.2019 dhe administrimit të observacioneve të noterës Ernela Çuberi,

KONSTATOJ :

Në zbatim të Urdhrit nr. 11772, datë 20.11.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për kryerjen e hetimit administrativ”, në datat 21.11.2018-23.11.2018, u ushtrua kontroll ndaj noterit publik Ernela Çuberi, e cila, në bazë të urdhrit nr. 8472, datë 28.12.2016 të Ministrit të Drejtësisë “Për dhënien e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit dhe përcaktimin e njësive vendore të ushtrimit të veprimtarisë noteriale”, duhet të ushtrojë veprimtarinë në Rrethin Gjyqësor Kavajë, Bashkinë e Kavajës.

Në përfundim të ushtrimit të kontrollit u konstatuan shkelje të rënda të ushtrimit të veprimtarisë noteriale, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë ushtrimin e profesionit të noterit, si vijon:

1. Shkelje të neneve 3/b, 12 dhe 16 të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe Urdhrit nr. 8046 datë 02.12.2004, të Ministrit të Drejtësisë “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, i ndryshuar, pasi sipas verifikimeve të kryera jo vetëm lidhur me vendodhjen fizike të zyrës së vetëdeklaruar, por nisur dhe nga tipologjia e veprimeve noteriale të kryera prej saj, verifikuar nga sistemi RNSH (Regjistri Noterial Shqiptar), rezulton se nuk e ushtron veprimtarinë e saj noteriale në vendin e caktuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Rrethin Gjyqësor Kavajë, Bashkia e Kavajës, sipas Urdhrit nr. 8472, datë 28.12.2016 të

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 3/b, nenit 7, shkronja "d)", neneve 8, 12, 16, 42, 45, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, "Për Noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Ernela Çuberi, anëtare e Dhomës së Noterisë Durrës, për shkak të shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit dhe të veprimtarisë së noterit.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj. Anisa Xake, nëpunëse e Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Znj. Eva Kenga, nëpunëse e Ministrisë së Drejtësisë;
 - c) Znj. Ina Papa, nëpunëse e Ministrisë së Drejtësisë;
 - d) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
 - e) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Durrës.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Ernela Çuberi, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë, dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
6. Arkivi noterial të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë, Durrës.
7. Arkivi t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45 ditor, një noteri pranë Dhomës së Noterisë, Durrës, që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shikimin e akteve.
8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.